



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-150

Prishtinë, më 24 mars 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 24 MARS 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sreten Ivanoviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
2. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

Pikat shtesë:

1. Zgjedhja e Avokati të Popullit

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se pas analizimit të nenit 9.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe të nenit 9 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit, është vlerësuar se ka paqartësi lidhur me procedurat e votimit dhe papajtueshmëri ndërmjet nenit 9.2 të Ligjit dhe nenit 9 të Rregullores.

Ai theksoi se në bazë të nenit 9.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit:

Avokati i Popullit duhet të zgjidhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e propozimit të kandidatëve. Nëse ky afat nuk është arritur, Kuvendi i Republikës së Kosovës voton për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në secilën seancë plenare për tridhjetë (30) ditë të tjera. Nëse Avokati i Popullit nuk zgjidhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, Komisioni përkatës i Kuvendit përsëri do të shpallë konkurs për Avokat të Popullit.

Ai tha se bazuar në karakterin imperativ të kësaj dispozite, me te cilën kërkohet që të bëhet zgjedhja e Avokatit të Popullit, propozoj që në seancën e radhës të përsëritet votimi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti, Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Ardian Gjini, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit, këtë pikë e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës, që të përsëritet votimi për të tre kandidatët për Avokat të Popullit.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kryesia, pas diskutimit, pikën e lartpërmendur e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës.

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 27 mars 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,
5. Zgjedhja e Avokatit të Popullit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

* * *

Kryetari i GP- të PDK-së, Adem Grabovci, i propozoi Kryesisë që të radhitet në rend të ditës për seancën e radhës edhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryesia, pas diskutimit, nuk e mbështeti propozimin e lartpërmendur me arsyetimin se për këtë projektligj ende nuk i kanë proceduar raportet Komisioni Funkcional dhe komisionet përhershme.

Kryesia, pas diskutimit vendosi që nëse Komisioni Funkcional dhe komisionet përhershme i procedojnë raportet me rekomandime deri javën e ardhshme, t'i propozohet seancës që Projektligji për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të radhitet në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës, sepse Kryesia nuk mund ta procedojë në seancë plenare në këtë fazë projektligjin e lartpërmendur.

2. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Procedimi i Projektligjit për deputetët

Për pikën e lartpërmendur diskutuan: Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti dhe Ardian Gjini, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit lidhur me projektligjin e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për deputetët, të hartuar nga Komisioni për Legjislacion, si dhe ta përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-në në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimi të projektligjit.

2. Shkresa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me ecurinë e Projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndërmarrje publike

Kryesia, pas diskutimit lidhur me pikën e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funksional që ta shqyrtojë shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për ecurinë e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësim të Ligjit për ndërmarrje publike dhe mbi bazën e kërkesës së tyre ta njoftojë AKP-në.

Pika shtesë:

1. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të delegacionit të grave deputete të Kuvendit të Shqipërisë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës në Kosovë të delegacionit prej pesë (5) anëtarësh të grave deputete të Kuvendit të Shqipërisë prej 27-28 mars 2014.

2. Të gjitha shpenzimet me rastin e pritjes së delegacionit pesë (5) anëtarësh të grave deputete të Kuvendit të Shqipërisë, duke përfshirë akomodimin dhe ushqimin, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale